



ISO-POLIFONIA

“Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit”, UNESCO



“A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity”

www.isopolifonia.com

Newsletter; Shkurt 2010, Nr. 4



Maksi Velo, pikturë “Grupi iso-polifonik Lab”

“Trashëgmia Virtuale”

Katalogimi dixhital i Isopolifonisë

Ilir Parangoni

“Fondacioni Trashëgmia Shqiptare”

Hyrje

Trashëgmia virtuale është term i cili përdoret për të përshkruar marrëdhëniet ndërmjet teknologjisë informative dhe komunikuese me trashëgiminë kulturore. M.g.j.t të dy termit janë të pavarur ndërmjet tyre: Trashëgmia Kulturore përfshinë atë materiale dhe shpirtërore së bashku me vlerat që ato kanë; ndërkohë që trashëgimia virtuale i referohet kërkesës së trashëgimisë kulturore me anë të teknologjive të reja të cilat mundësojnë dhe thjeshtësojnë praktikën e ruajtjes në mënyrë sa më moderne të informacionit. Një element në këtë kuadër është edhe mekanizmi i *database* (arkiv dixhital).

Projekti

Projekti i katalogimit dixhital të Isopolifonisë filloj në janar 2008 me iniciativën e Prof. Vaso Tole dhe në bashkpunim me M.A Ilir Parangoni (Fondacioni Trashëgmia Shqiptare). Për herë të parë, merret një iniciativë serioze për katalogimin dhe dixhitalizimin e trashëgimisë shpirtërore duke synuar regjistrimin e informacionit rreth muzikës së Iso-polifonisë brënda kuadrit të mbrojtjes dhe ruajtjes së saj.

Ky projekt *synon* gjithashtu, gjetjen, studimin dhe grumbullimin e informacionit rreth dhe lidhjet e saj me fusha të tjera

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është ruajtja, regjistrimi dhe katalogimi i Isopolifonisë e cila që prej vitit 2005 është bërë pjesë e Trashëgimisë Botërore dhe mbrohet nga UNESCO.

Me terma afat-gjatë ky projekt, *ka për qëllim*, gjithashtu, të bëjtë mundësinë e informacionit të mbledhur nëpërmjet faqes zyrtare të www.isopolifonia.com në internet duke e bërë këtë informacion të hapur për të gjithë.

Në ndërtimin e këtij arkivi dixhital jemi munduar t'i përmbahemi dhe t'i zbatojmë në mënyrë sa më rigorozë standartet e organizatës botërore për katalogim dokumentimin (CIDOC).

Ndërtimi dhe klasifikimi i skedave në database.


Ndarja dhe vlerësimi është kryer në bazë të kriterëve të vlerësuar nga Prof. Vasil Tole dhe *database* është regjistruar pranë zyrës shqiptare të të drejtave të autorit. Ky arkiv është konceptuar në një kënvështrim të gjërë të


Isopolifonisë, duke përfshirë shumë fusha që lidhen me të duke filluar nga arkeologjia apo veglat tradicionale, grupet, vallet, Legjislacionet, mjeshtrat si dhe shumë element të tjerë. Në këtë arkiv brënda skedave përfshihen këngë në mp3, video të aktiviteteve apo koncerteve dhe debutimeve të këngëtareve të ndryshëm të kësaj trashëgimie.

Ecuria dhe prespektiva.

Për momentin ky projekt ndodhet në fazën e mbledhjes e të dhënave dhe hedhjen e tyre gradualisht në skeda elektronike. Më pas ky *database* do të ritrajtohet nga ana elektronike duke transferuar informacionin e mbledhur në një server qendror duke synuar një format sa më të gjatë të informacionit dhe publikimin më pas në faqen zyrtare www.isopolifonia.com. Këtu të dhënat do të jenë të aksesueshme nga kushdo që është i interesuar në lidhje me Isopolifonisë dhe kërkon të informohet rreth saj. Ndërsa paralelisht, në mbështetje të kësaj nisme, kemi shfrytëzuar burime të tjera alternative *online* si Facebook, Youtube etj. në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të kësaj trashëgimie botërore.

Portali





Veglat e IP me saze IP. DATABASE

Studuesit e Isopolifonise

PORTALI


Gerneta

Violina

Llauta

Fisarmonika

Dajre



Isopolifonia zanore labe IP. DATABASE

Isopolifonia zanore labe

PORTALI

Isopolifonia Labe

Isopolifonia Toske

Tipologjia e zerave

Gjinite

Grupe Isopolifonike

Mjeshtra kengetare

Fjalori i Isopolifonise



Veglat e Isopolifonise IP. DATABASE

Veglat e Isopolifonise

PORTALI

Kodi i Venies

Lloji i Venies

Aerofone

Fmri i Venies

Fyell

Vendodhja

m. Vegjet muzikore

Kush e interpreton

Fyellitani esthite

Te dhienat teknike

Per fuq plotesuar

Memorat e interpretimit

Per fuq plotesuar

Bibliografia

Straboni, "Geographica", lib. VI, kap. 318, Buzuku Gjon, "Meshari", Tiranë, 1908, Bogdani Ramazan, "Fjalori koreografiki i Hasit", Tiranë 1977; "Fjalori i mitologjise", 1997



Foto



Skica

Muzik

Google Custom Search

news

Projekti:

"Mbrotjtja e Iso-Polifonise Popullore shqiptare"

www.contactmusic.com/new/artist/nsh/artistnames/tm%20fyell - 27K - [Cached](#) - [Similar pages](#)

melodi me fyell FREE MP3

home > mp3 search > results for melodi me fyell songs (you are here) ... free mp3 downloads - melodi me fyell free music downloads ...

www.aimp3.net/search/melodi_me_fyell/mp3/a1 - 36k - [Cached](#) - [Similar pages](#)

Video results for Fyell

YouTube - Malesori me fyell
1 min 28 sec
[www.youtube.com](#)

Fyell i gjalle
2 min 58 sec
[www.youtube.com](#)

Where Fyell Families lived in Scotland in 1891 - Ancestry.com

View many different Fyell family history facts from birth, marriage, and death military records, census records, immigration records, ...

www.ancestry.com/facts/Fyell-family-history-sets - 55k - [Cached](#) - [Similar pages](#)

Grupi Vranisht - Melodi me fyell - eSnips. share anything

Grupi Vranisht - Melodi me fyell - eSnips. share anything

Isopolifonia në valle IP. DATABASE

Isopolifonia në valle

PORTALI

Vallet me saze


Vallet e kënduara

Veshjet popullore



Emri i grupit	Foto e grupit	Vendi i krijimit gr.	Isa e grupit	Rapsodi e grupit	Kthyesi i grupit	Presesi i grupit	Muzika e gr.	Marresi i grupit	Repartori i grupit
Pleude e Gjirokastrës		VLORE	Jonuz Shehu, Demo	Populli	Skender Tushë	Javer Erindi dhe Toto Kostasidin Thana	Xhevat Avdull	Rreshat Osmani	Nësi këngëti e Formacioni muzikor
Grupi iso-polifonik		VLORE	Në ndihmë të	barilori Konstandin	pop. Bashkërisht		nenori Reshat		Nësi këngëti me të
TRIO VLONJATE		VLORE		DERVISH ÇUMA	AGRON SELIMI		GOLIK JAJUPI dhe		"Billobinësh neve ARJAN SHENJU
GRUPI I BENCES		BENÇE, TEPELENE		PERLAT MELI	MEHMET VISHE				
GRUPI ERÇURIA		ÇURKËKËSTER	Adilbaki Çenko						
VEZHDAVËSHIT		VLORE			NEBI SIMO	YZEDIM SIMO			VENDIM ZYKA dhe
CIPRI		VLORE		TOMOR LELO					

Foto	Objekti Arkeologjik	Lloji i materialit	Vendgjetja	Skica	Periudha	Vendodhja
	Pani me Siringe	Mermer	Parku Arkeologjik,		Shek. IV. P.e.s	Muzeu Kombetar,
	Skene Argetimi	Bazoreliev	Parku Arkeologjik,			
	Apoloni me liren e	mermer	Zona Arkeologjike e			
	Sirena Vajlore	Mermer	Parku Arkeologjik,		Shek. III P. Krishtit	Muzeu Kombetar,
	Muza e muzikes	Mermer	Parku Arkeologjik,		Shek. II, P. Krishtit	Instituti Ndokombet
	Sirena	Bishiti i Pallos, Durres			Shek. IV, P. Krishtit	Muzeu Kombetar,
	Sirena vajtoze	bronz-metal	Parku Arkeologjik,		Shek. IV, P. Krishtit	Austri
	Sirenat e Apolonise	Mermer	Parku Arkeologjik,			
	Muzikanti antik	bronz				
	Kembore mesjetare	bronz	Parku Arkeologjik,		Shek. V. P.E.S	Muzeu Kombetar,
	Gongu	Bronz-metal	Parku Arkeologjik,			Muzeu Kombetar,
	Cimbalet	bronz-metal	Parku Arkeologjik,			Muzeu Kombetar,
	Valltare antike	gur	Muzeu Kombetar,			
	Sirena Vajtoze	gur	Parku Arkeologjik,			Parku Arkeologjik,
	Amfore me skena	qyteti antik i Durresit			shek. II-II, P.e.s	Muzeu Arkeologjik,
	vallezim, ene	qyteti antik i Durresit			shek. III. p.e.s	Muzeu arkeologjik
	instrumentisti me	qeramike	qyteti antik i Durresit			Muzeu arkeologjik,
	stoli idiofone	ar dhe argjend	qyteti antik i Durresit			Muzeu Arkeologjik,



“MASH, ministri per dixhitalizimin”

z. Myqerem Tafaj



“Qendra e Studimeve Albanologjike ofron për herë të parë studime master dhe doktorate”.

Ministri i Arsimit Tafaj : Studimet në QSA, është premtimi i mbajtur i Qeverisë Berisha.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës mori pjesë në hapjen e studimeve të masterit dhe doktoraturës nga Qendra Shqiptare e Studimeve Albanologjike.

Bashkimi i Instituteve Kërkimore të Arkeologjisë, Gjuhësi dhe Letërsisë, Historisë, Kulturës Popullore, si dhe i dy Qendrave Kërkimore, asaj të

Studimit të Artit dhe asaj të Enciklopedisë Shqiptare, të riorganizuar tashmë në Qendrën Ndëruniversitare të Studimeve Albanologjike (QNSA), nisi për herë të parë në Shqipëri, studimet master dhe doktoraturë për 140 të rinj shqiptarë, prej tyre dhe 15 nga trojet jashtë vendit.

Në përshëndetjen e tij, Z. Myqerem Tafaj vuri në dukje se nisja e studimeve master dhe doktoratë nga kjo qendër, është tregues i qartë i premtimeve të mbajtura të Qeverisë Berisha. Ai vlerësoi se shkollimi i të rinjve prej QSA-së, ka veçori, krahasuar me studimet e tjera, pasi këto studime përbëjnë një bazë të mirë të kërkimeve shkencore.

“Pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike janë ofruar nxënës të shkëlqyer dhe kjo përbën një premisë bazë për mastera dhe doktorata shumë të mira, duke ruajtur statusin e qendrës më të mirë në nivel shkencor”, - tha Tafaj.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës shtoi se kriteret e ekselencës në të cilat e mbështet punën QNSA, duke garantuar nivel të lartë formimi për studiuesit e së ardhmes dhe se strategjia e qeverisë për arsimin dhe shkencën synon që, brenda një periudhe të shkurtër, ta forcojë sistemin universitar dhe pasuniversitar të studimeve, për ta ngritur atë sa më shpejt në standardet e afirmuara europiane.

Në fund të përshëndetjes së tij, Ministri Tafaj ndau në mënyrë ceremoniale, përpara auditorit të mbushur me studentë të QNSA dhe me punonjësit shkencorë të këtij institucioni të rëndësishëm, diplomat për tre punonjës të QNSA që u nderuan me titullin “Profesor-Doktor”.

QSA, aktualisht me rreth 100 punonjës shkencorë e specialistë të kualifikuar, është një ndër institucionet ndëruniversitare e kërkimore të rralla që vë në shërbim të formimit të thelluar të studentëve e të kërkuesve të rinj pothuaj një specialist për çdo student të pranuar në shkollat e saj të Masterit e të Doktoraturës.

“Intervistë me Ramadan Sokoli”

Faksimilet Haki Koci



Kolosi i etnomuzikologjisë shqiptare flet për kalvarin e vuajtjeve të shumta gjatë regjimit komunist

Pse transmetohej pa emër muzika ime në Radio “Tirana”?!

Prof. Ramadan Sokoli

Kush është Ramdan Isuf Sokoli

“ Lindi në Shkodër në 14.06.1920 në gjirin e një familje qytetarësh të pasun. Zanafilla e të tij del nëpër gojëdhëna e sipas një peme gjenealogjike, thuhet se kjo famije rrjedh nga fshati Bojaj i Sumës së Malësisë së Madhe.

“ Është marrë me muzikë që në shkollën fillore, ku ishte ngritur nje fanfarë veglash frymore të tunxhit. Në këtë shkollë mësoi përdorimin e disa veglave. Më vonë gjatë shkollës së mesme mësoi përdorimin e violinës si dhe të disa veglave me tela. Në moshën 16-vjeçare filloi të krijoj këngë.

“ Gjatë viteve ‘30 ndoqi studimet e larta në konservatorin “Luigi Cherobini” të Firenzes, për flaut e kompozicion.

“ Në vitin 1945-1946 emërohet si instruktor muzike në Ministrinë e Kulturës në Tiranë. Më vonë u punësua si instruktor i filarmonisë shqiptare. Por pas një viti, për shkaqe biografie e pushuan nga puna. Pas pak kohe e emërojnë në Shtëpinë e Kulturës (1952-1953), por edhe aty e pushuan po për shkaqe biografie. Së andejmi, punësohet në Liceun Artistik si arsimtar për flaut si dhe për disa lëndë të ndryshme. Aty, për herë të parë futi në programin mësimor lëndën e Folklorit Muzikor, duke bërë vetë dhe përpunimin e teksteve dhe programin.

“ E nxorren në pension në moshën 55-vjeçare, si një arsimtar të thjeshtë, në një kohë që e ndjente veten ende shumë të fortë për të dhënë e punuar më shumë.

Sipas dëshmimeve të shkruara në Arkivën e Raguzës, Sokolajt rrjedhin nga malësorët e Dalmacisë. Të parët tanë kishin lidhje krushqie me feudalët e vendit. P.sh.Ibrahim Pashë Bushati u martua me Fifen e Dervishajve (alias Sokoli). Dikur këto lidhje krushqie u prishën më Vezirin e fundit Mustafa Pashë Bushati, për shkak të vrasjes së nipave, (të cilët nuk duhet të trashëgonin titullin e familjes, por ishin fëmijët e tij që duhet ta trashëgonin). Ky kob mizor la oshëtima të mëdha. Mahmut Beu (stërgjyshi im që shpëtoi gjallë) iku me prindërit e vet dhe me kushërinjtë e vet dhe u strehua në pallatin e Sulltanit të Stambollit, ku punuen si administratorë. Pas rënies së Mehmetit, Vezirit të Shkodrës, këta u kthyen në atdhe bashkë me kushërirën e vet dhe rindërtuan shtëpinë në Shkodër, ku linda dhe u rrita dhe unë.

Pra, siē thashë më lart, të parët e mi kishin lidhje me Hamza Kazazin, Iliaz Pashë Dibren etj. Aso kohe Shqipëria shtetërore përbëhej nga katër vilajete: Shkodra, Shkupi, Manastiri dhe Janina.

Bash në kohën e iluminizmit dhe të Kongresit të Berlinit, vendi ynë mjerisht u cilësua nga diplomacitë “një shprehje gjeografike”, prandaj shqiptarët patriotë po flijoheshin për copëtimin e vendit tonë, i cili po ndahesh në katërsh, duke e gjymtuar nëpërmjet kufijve të dhunshëm. Në këto rrethana, Hodo Mahmut Sokoli la votrën për mbrojtjen e tërësisë tokësore. Një mori burrash trima e liridashës u tubuan në Bibliotekën e Pazarit të Vjetër. Hodo Mahmut Sokoli, nga ballkoni i ngrehinës, mbajti një fjalim të zjarrtë: Pastaj shkëputi dekoratat dhe gradat e larta, madje zhveshi rrobat ushtarake dhe i zëvendësoi me rroba kombëtare. Ndërkohë, u hoq nga shtiza flamuri turk e në vend të tij u vu flamuri kombëtar shqiptar. Kjo ngjarje e shënuar bëri jehonë të madhe-siē u shpreh poeti kombëtar Gjergj Fishta: Nëpër shtatë krajlitë i vojti nami, Ky nam është ruejtë deri më sot nëpërmjet këngësh popullore, të cilat vijuan të këndohen deri në kohën tonë:

Hot e Grud ishin betue,

Ulen n’Shkodër me ba dert,

Pa gjak malet mos me i lshue,

Jena nisë me u ba millet.

Shkodër e Malësi janë ēue,

Duen me zgjedhë një komandant.

Hodo Pasha asht emnue,

Nuk ka ēajre pa na ardhë.

Trimat shqiptarë të kryesuar nga komandanti i tyre te ura e Rrzhanicës, qëndruan e ngadhënjyen. Ketë ngjarje me të drejtë e përmendin si një akt demokratik e heroik të historisë tonë kombëtare.

Më vonë i kurdisën një grackë, e futën në një anije luftarake turke dhe e dërguan në Stamboll ku i bënë gjyqin, së andejmi, të dënuar e dërguan në Azerbajxhan, ku vdiq, ose më mirë plasi nga marazi.

Në jetën familjare ai ishte fatkeq. E kush mund t’i tregojë vuajtjet e tija. Në vitin 1936, Mehdi Frashëri, ministër i Qeverisë së atëhershme, i vuni emnin “Hodo Beg” një rruge në Tiranë dhe një rruge në Shkodër, për ta nderue këtë hero kombëtar. Unë përshebull u linda në këtë shtëpi dhe u rrita me një frymë patriotike me një dashuri të madhe për atdheun.

Si u inëizuan rreth 1000 pjesë në shirit magnetofoni?

Jam marrë me muzikë që në shkollën fillore, ku ishte ngritur një fanfarë veglash frymore të tunxhit. Në këtë shkollë mësova përdorimin e disa veglave. Më vonë gjatë shkollës së mesme mësova përdorimin e violinës si dhe të disa veglave me tela. Në moshën 16-vjeëare fillova të krijoj këngë, si psh: Blegëron delja, me tekst popullor.

Më vonë nxora këngën “Lulja me erë”, e cila u përhap edhe përtej kufijve shtetëror, nëpër Kosovë. Theksoj se kjo këngë, gjatë lëvizjes studentore 1981-1985, me tekst të ndryshuar u bë një hymn, kushtuar lirisë kundra shtypjes kombëtare e gjenocidit serb.

Gjatë viteve ‘30, vajta në Itali, ku ndoqa studimet e larta në konservatorin “Luigi

Cherobini” të Firenzes, për flaut e kompozicion. Nuk kisha bursë e asnjë ndihmë shtetërore, meqë im atë ishte i internuar politik nga fashistët. Nga kjo kohë midis krijimtarisë vokale e instrumentale, mund të përmendë një “Nokturn”, përkushtuar shokut tim, Qemal Draëini, i cili më 1947 vdiq si martir në birucat e sigurimit.

Pasi u riatdhesova, u emërova si instruktor muzike në Ministrinë e Kulturës në Tiranë, në vitin 1945-1946. Më vonë u punësova si instruktor i Filarmonisë Shqiptare. Por, pas një viti, për shkaqe biografie më pushuan nga puna. Pas pak kohe më emëruan në Shtëpinë e Kulturës 1952-1953. Edhe aty më pushuan po për shkaqe biografie. Së andejmi më punësuan në Liceun Artistik si arsimtar për flaut si dhe për disa lëndë të ndryshme. Aty, për herë të parë futa në programin mësimor lëndën e Folklorit Muzikor, duke bërë vetë dhe përpunimin e teksteve dhe programin. Ndërkohë vazhdoja lëvrimin e etnomuzikologjisë në terren, duke kryesuar **ekspedita shqiptaro-gjermane** (1957), si dhe shqiptaro - romune (1958). Nëpërmjet ekspeditave të larpërmendura u inëizuan rreth 1000 pjesë në shirit magnetofoni.

Fillimisht transmetohej muzika ime në Radio “Tirana”, por pa emër. Pak e nga pak filluan të jepnin ndonjë edhe me emër, si p.sh., rapsodi për pianoforte, Koncert për flaut e orkestër, duete për vegla frymore (flaut, oboe ose klarinetë). Një kuintet veglash frymore. Një kuartet për klarinetë e harqe, disa miniatura për klarinete e harqe, Elegji për violë e violinë, Valle për orkestër, “Buzë liqenit” (Suite orkestrale). Gjithashtu janë botuar dy vëllime me miniatura për piano. Ndërsa për vokalet janë përpunuar disa syresh, si Tufë këngësh për fëmijë, Mallëngjimi arbëror, Burimi në Mal, Dhimbja e nënës, Kënga e fundit e

Jeronim de Radë, Dimri-sipas poezisë së Ndre Mjedës, Korale e shoqëruar më pianoforte.

Ndihma e gjuhës sonë për muzikologjinë

Nga botimet e shkruara po përmend:

Vallet shqiptare nëntor 1954

Fjalët e përmbledhura në lëmin e muzikologjisë, në buletin shkencor 1956

Metrika dhe prozodia jonë popullore (nëntor 1953)

Melodika jonë popullore 1960

Humori dhe satira në lirikën tonë popullore 1961

Rreth muzikës sonë popullore 1961

Rreth muzikës shqiptare në kohën e Skënderbeut, Muzika dhe shkenca (Revista Shkenca dhe jeta”)

Figura e Ali Pashë Tepelenës (Revista “Ylli” 1970)

Mbi Veprimtarinë e Fan Nolit si kompozitor

Këngët e dashurisë, në revistën “Mehr-licht”

Sistemet e shkrimeve muzikore, Rev.”Ylli”

Gjenezja e flamurit dhe Hymnit kombëtar,

Hyllësi e këngëve të bektashianëve

Përveç këtyre janë botue në frëngjisht në revistën “Les lettres albanaises” një numër artikujsh për personalitetet e kulturës dhe muzikës shqiptare, duke filluar me Niketë

Dardanin i shek.IV, Jan Kukuzeli i shek.XII, Letërkëmbimi Dragomirshizkit me Gjergj Kastriotin, Skënderbeun: Fan Nolin, si dhe një seri artikujsh për piktorë, skulptarë e arkitektë. Disa më të rëndësishmit janë: Lahuta dhe këngët e kreshnikëve; Ndihma e gjuhës sonë për muzikologjinë; Rreth gurrave të muzikës sonë popullore; Gjama mortore; Folklori muzikor shqiptar; Lorenc Antoni; Kryeveprat e artit parahistorik etj. Shto këtu edhe disa shkrime të botuara në Revistën “Shqipëria e re”, në gjuhë të huaj, si dhe në gazetën “Eurorilindja, dhe në revistën “Pionieri”.

Janë skedarizue pra disa qindra shkrime të botuar në biblioteka të ndryshme. Ndër këto dallohen edhe librat:

1. 1.Les dances populaires et les instrument musicaux du peuple Albanais - Tiranë 1958
2. 2.Chansons populaires Albanais (Albanskije narodnjije poesni) Tiranë, 1965
3. Figura të ndritura - Jan Kukuzeli e Andrea Aleksi, Tiranë 1965
4. Folklori muzikor shqiptar -Morfologjia, Tiranë 1965
5. Metodë për fyer, Tiranë, 1970
6. Vallet dhe muzika e të parëve tanë, Tiranë 1971
7. Folklori muzikor shqiptar - Organografia, Tiranë, 1970
8. Veglat muzikore të popullit shqiptar, Tiranë, 1984
9. Figura e Skënderbeut në muzikë, Tiranë, 1978

10. Gjurmime folklorike, Tiranë, 1982
11. Këngët patriotike, Tiranë, 1985
12. Veglat muzikore të popullit shqiptar, Tiranë 1991
13. 16 Shekuj, Tiranë, 1995
14. Në botën e gojëdhënave shqiptare, Tiranë, 2000
15. Antifonari i Durrsakut Danush Gjergj Lapacaja, Tiranë, 2001
16. Përtej 16 Shekujsh, Tiranë, 2002
17. Pjesë shqiptare për fidanishen e pianistëve të rinj, Tiranë, 2002
18. 20 miniatura pianiste, Tiranë, 2002
19. Krijime e flijime, Tiranë, 2003

Përveç këtyre më mbeten për të shtypur rreth katër vëllime mbi doket e zakonet “Nga djepi deri në varr”; “Rreth mjeteve popullore”; Rreth 12 mijë vargje të këngëve popullore.

Kjo nuk është punë e pakët dhe as e vogël.

Më nxorën në pension në moshën 55-vjeçare, si një arsimtar i thjeshtë, në një kohë që e ndjeja veten ende shumë të fortë për të dhënë e punue ma shumë. Megjithatë, edhe në kushte të vështira, ndër presione të ndryshme politike e psikologjike nuk jam dorëzue, por kam vazhdue me punue, e sot më vjen keq që nuk kam mund me dhanë edhe më shumë. Duhet të përmend këtu faktin se të gjithë meshkujt e familjes sime janë burgosur nga i ashtuquajturit pushtet popullor:

Baba plak, pak kohë pas riatdhesimit nga internimi fashist, u dënua dy vjet burg, unë u dënova 4 vjet e gjysëm, vëllau i vogël u dënue 25 vjet, ndërsa vëllau i madh i burgusur e i internuar 27 vjet.

Gjatë 14 muajve të hetuesisë sime përjetova vuajtjet mizore të pa përshkrueshme. Kush e ka provue mund ta di. Martirët e mjerë se ë'kalojnë, por si në shtratin e Prokustit. Në asi kushtesh kobëzeza zor se mund te qëndroje e dilje së andejmi. Por krahas të këqiave pëson e mëson kush qëndron i pa përkulshëm e i kalitet karakteri.

Pas periudhës së hetuesisë, në gjygin tim ishin 12 të pandehurit, ndër të cilët dhjetë ishin djem e vajza të reja. Gjykimi im zgjati vetëm dy seanca gjatë dy mbasditeve. Ata të ashtëquajturit dëshmitarë, që na ballafaquan me deponime të detyruara i kemi falur. Megjithëse në gjendje të rëndë fizike jam përpjekur me qëndrue.

Shumkush thotë: “Të shkuara të harruara”, por si do të harrohen këto mizori.

Pas dënimit vuajtëm në burgun e kanaleve të Bedenit (Myzeqe), një detë mjerimi i pafund, ku lëvrohej urrejtja e martirizimi, por shpresa për të mbijetuar na jepte një fuqi mbinjerëzore. Periudha e burgut zhduku vlerat njerëzore e intelektuale të shumë njerëzve. Demoralizimi e ëoroditja ishin dëmet më të mëdha që i bëri epoka e diktaturës komuniste popullit shqiptar. E i gjithë ky makth kaloi. Shumë njerëz nuk janë më, i kujtoj të gjithë me mall, me keqardhje e me nostalgji.

I etur si gjithnjë për dritë e për dije, dëgjoj muzikë të zgjedhur, e cila më zhyt në përfytyrime të bukura. Më pëlqen shumë të depërtoj përtej të fshehtave, përtej

makrokozmosit. Kush sodit përtej apsirave të pa fund, shumë shumë larg përtej...

I dua lulet, i dua zogjtë që cicërojnë, i dua kafshët e bukura, sidomos i dua fëmijët e padjallëzues. Kur dëgjoj muzikë të bukur, nuk e ndjej veten të vetmuem. Nuk më pëlqejnë qaramanët porsì shelgjet lotuese; nuk dua t'u shëmbëllej atyne. Do të doja të kisha ende jetë, sepse më vjen keq që nuk dhashë më tepër!

Rilindja Demokratike, 29.09.2007

“Kur bashkëkohësia ndërtohet mbi traditën”,
Në vend të hyrjes për librin e Dr. Resul Llogos “Një jetë me këngë”

Prof. Dr. Vasil S. TOLE



Kur shkruan një hyrje për një libër si ky, që Dr. Resul Llogo ka përgatitur, me rreth 200 poezi folklorike të iso-polifonisë labe, sigurisht që pena të mprehet vetë dhe ashtu si pjestari i një grupi iso-polifonik që bëhet gati për të kënduar, edhe ti fillon të përgatitesh që zëri tënd të vejë fjollë, së bashku me shokët. Kjo gjë të lehtësohet shumë kur mendon se je në një grup, e krah për krah me shokë si Resuli, i cili edhe si studiues, si drejtues i institucioneve vendore të Shqipërisë së Jugut por dhe si bartës i iso-polifonisë të bën udhërrëfyesin në shtigjet e vështira të iso-polifonisë së Jugut.

Dua të them shumë gjëra, por më ler të them së pari ato që vërtet i çmoj në jetën dhe punën tënde Resul.

Që në fillim po të them se je i mirëpritur me këtë libër! Je i mirëpritur se nga iso-polifonia, në faqet e librit tënd, përmes këngëve të popullit, ti vetë mësove dhe na mëson edhe ne të tjerëve të parin mësim: që punët e mira bëhen bashkë. Pse

vete mirë kënga Resul? Thuaje dhe njëherë ta dëgjojnë më mirë ata që se dëgjuan! Kënga vete mirë o djem se trupi, shpirti dhe zërat e këngëtarëve bëhen një; se gëzimi dhe hidhërimi përshkron trupat dhe zemrat si të kalonte në një trup të vetëm; se vetëm kështu lind kënga iso-polifonike, nga zemra, trupa dhe zëra të bashkuar. Këtë dëgjova dhe pashë në librin tënd më së pari!

Je përsëri i mirëpritur se me njerëz si Ty, këngëtarë të denjë në skenë dhe dinjitozë në jetë, ashtu si në një këngë iso-polifonike punët venë mbarë e më mbarë, për një komunitet, por dhe për vendin. Nuk është rastësi Resul, që Gjirokastra u shpall “*Pasuri kulturore e njerëzimit*” në vitin 2004, ashtu si iso-polifonia “*Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit*”, një vit më pas nga UNESCO.

Ishe edhe Ti! Si thotë poeti: *Si një iso e pavënëre/në këngët e popullit edhe unë kam hyrë!* Ashtu bëre. Nuk le gur pa lëvizur, punë pa bërë dhe “*këngë*” pa kënduar që këto vlerat tona të mahnitshme t’i njihte dhe çmonte gjithë bota. Bëre kështu, se ashtu u rrite dhe edukove edhe në këngët e tua: *Bukurinë duaje, shijoje dhe çmoje se të bën më të mirë!* Faleminderit Resul për punën tënde të paçmuar!

Je gjithmonë i mirëpritur, se aty ku ishe ti, iso-polifonisë nuk ju mek as zëri dhe as pamja. Përkundrazi. Iso-polifonia falë teje u këndua më shumë, u kërcye deri në tavan, dhe më shumë grupe të rinj krahas të

vjetërve gjallëruan Gjirokastrën, qarkun e saj dhe Jugun e Shqipërisë. I kujtuam por dhe u kënduam edhe atyre që nuk jetojnë më. Se ata janë aty, në korrin e madh të traditës tënde. Në fillim iso-polifonia të rriti pastaj ti e mbajte atë me çdo mënyrë, siç po bën edhe me këtë libër. Kudo ke miq Resul! Në Gjirokastër, Përmet, Vlorë, Korçë, Leskovik, Pogradec, Devoll, Dropull, Pogon, Andon Poçi, Gramsh, Berat etj. Edhe mua më ke. Jemi miq të vertetë, miq të zënë prej iso-polifonisë.

Do të mbetësh i mirëpritur se iso-polifoninë e këndove edhe në shqip, edhe në greqisht edhe në vllaçe. Ku ka më mirë se fjala dhe dollia tënde nën tingujt e sazeve të evgjitëve? Kjo është vlera tënde o lum miku! Ti e di mirë dhe na i kujton edhe ne të tjerëve se është më mirë të gjëmojnë kudo zërat mulikulturorë të iso-polifonisë, sesa zhurma pa kuptim? Prandaj je iso-polifonist Ti! Se ti di tja marrësh, tja kthesh, t'ja hedhësh, por dhe të bësh edhe iso, kur e sheh që dikush tjetër këndon. Nuk ka bashkëkohësi më të bukur se kjo që kë ndërtuar mbi traditën tënde. E-o!



Ps: Shkrimi botohet si nje homazh pas vdekjes parakohshme të mikut dhe kolegut tone Z. Resul Llogo ne vitin 2009.

“Grupi Folklorik “Vëllezërit FRASHËRI”, këngëtar i shquar i muzikës lirike dhe asaj iso-polifonike popullore shqiptare”



Kryesia e Shoqatës Atdhetare Kulturore “Përmeti” më 7 prill 2007 vendosi ngritjen e Grupit Folklorik “Vëllezërit Frashëri” të Shoqatës Atdhetare Kulturore “Përmeti”. U arrit ngritja e këtij grupi me vlera në sajë të punës së studjuesit të kulturës dhe historisë Kastriot Bezati dhe të muzikantit Ylli Muco. Ngritja e këtij grupi ishte me kohë në programin e kësaj shoqatë sepse e kërkonte atë qëllimi dhe përmbajtja e vetë Shoqatës AK “Përmeti”. Kryetari i kësaj shoqate, zoti Ibrahim Toshkësi, i cili më shumë sekushdo ka punuar dhe punon për fuqizimin dhe lartësimin e Shoqatës “Përmeti”, thotë: “Ngritjen e Grupit Folklorik “Vëllezërit Frashëri” e kërkonte ndërjegjja dhe emblema e Shoqatës “Përmeti”. U ngrit ky grup me artistët e talentuar, që i ka lindur toka e Përmetit në sajë të punës së palodhur të studiuesit me vlera në fushën e kulturës dhe historisë, zoti Kastriot Bezati. Grupi do të shpalojë brenda e jashtë vendit vlerat më të mira kulturore të Përmetit. Ylli në fizarmonikë, Genci, Josifi e Sadiku në klarinetë, Jareku në llahutë, Arturi në violinë dhe Arbani në daire, janë të gjithë mjeshtra të instrumentave të folkut, virtuozë të muzikës me saze të Përmetit. Vaska, Donika, Jolanda, Evgjenia dhe Arbani janë këngëtarë të talentuar dhe me kontribute të vecanta të këngës së mrekullueshme qytetare popullore të Përmetit. Këta artistë i kanë dhënë shumë kulturës së Përmetit dhe tani ata së bashku si grup i organizuar i Shoqatës “Përmeti”, nën drejtimin e nënkryetarit të shoqatës zotit Kastriot Bezati, do të evidentojnë e lartësojnë kudo me koncertet që do të japin brenda e jashtë vendit kulturën e cmuar të Përmetit. Urimet e mija më të mira Grupit “Vëllezërit Frashëri” të Shoqatës Atdhetare Kulturore “Përmeti”.

Sazet dhe kënga popullore qytetare e Përmetit janë tashmë jo vetëm të njohura, por edhe të mirëpritura në viset shqiptare brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ato janë të njohura dhe të mirëpritura edhe më gjërë. Kabaja përmetare, kabaja e usta Laver Bariut, gjeneral në klarinetë, muzika dhe kënga me saze e Përmetit, janë nga majat e folkut tonë të mrekullueshëm, bëjnë pjesë në krenarinë e folkut shqiptar dhe hyjnë në vlerat nga më të mirat e folkut të Ballkanit. Kënga ka dhe instrumentet e saj, më kryesoret nga të cilat sot janë: klarineta, llahuta, violina, defi dhe fizarmonika. Instrumentistët janë njëherësh edhe këngëtarë. Kënga fillon, zhvillohet dhe përfundon si këngë lirike. Kush e ka dëgjuar atë vështirë është të mos flas për ngrohtësinë, muzikalitetin, ëmbëlsinë, harmoninë, rrjedhshmërinë, qartësinë dhe poezinë e këngëve të bukura të Përmetit.

Artistët e Grupit “Vëllezërit Frashëri” kanë marrë pjesë e janë vlerësuar pothuajse në të gjitha takimet e festivalet kombëtare në Shqipëri. Instrumentistët e grupit janë të talentuar. Si klarinetistët Genci Muco, Josif Shukollari e Sadik Zeqiri, në llahutë Jarek Muco, në violinë Artur Zeqiri, në dajre Arban Zeqiri dhe në fizarmonikë Ylli Muco. Në përbërje të grupit janë këngëtarët Vaskë Curri, Jolanda Tralo, Donika Pecallari, Evgjeni Culli si dhe Arban Zeqiri, që është si cilësuar edhe në orkestër, si dajrexhi. Këta këngëtarë janë sot në piedestalin e këngës popullore qytetare të Përmetit. Secili këngëtar i grupit ka jo një, por disa CD, të cilat pëlqehen e kërkohen brenda dhe jashtë Shqipërisë. Instrumentistët dhe këngëtarët e këtij grupi kanë punuar e janë ngjitur në skenë brenda dhe jashtë vendit me klarinetistin e madh Laver Bariu. Artistët e këtij grupi kanë marrë pjesë edhe në mjaft takime e festivale ndërkombëtare, si përshebull në Francë, Greqi, Turqi, Suedi, Finlandë e Norvegji. Ata kanë marrë pjesë dhe janë vlerësuar edhe në festivalet e organizuar në Kosovë.

Në vitin 2004, në Festivalin Komëtar të Sazeve në Korçë, sazet e Përmetit u nderuan me Cmimin e Dytë, ndërsa në Festivalin e 7-të Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, Grupi Folklorik i Përmetit u vlerësua ndër të tjerët me Kupën e Festivalit. Si në Korçë ashtu dhe në Gjirokastrë ishin artistët e këtij grupi që i dhanë këto cmime Përmetit.

Kastriot Bezati dhe Ylli Muco janë respektivisht Kryetar dhe Udhëheqës Artistik të Grupit Folklorik “Vëllezërit Frashëri” të Shoqatës Atdhetare Kulturore “Përmeti”.

“Të njohim grupin iso-polifonik, Jehona Labe, Vlorë”,



Krijuar ne shkurt 1999, me Kengetare nga treva te ndryshme te Vlorese Laberise, gje qe perben dhe karakteristiken te ketij grupi, “Jehona Labe” ka qene mjaft e suksesshme ne veprimtarine e saj,

ne te cilen radhiten nje sere koncertesh brenda dhe jashte Shqiperise, si ne Greqi, Izrael, Tirane, Tepelene, Berat, Fier, Vlore, etj.

Repertori i Grupit perfshihet ne tre Albume, ku permbahen reth 70 kenge, melodi, ligjerime, kenge lirike, patriotike, Humoristike, etj. “Jehona Labe” eshte Laureant i festivalit Folklorik Kombetar Gjirokaster ne shtator 2000, me kengen “Hamit Guga nje pellembe” kenduar nga Berdo Berdaj.

Grupi:

1. Poeti popullullor, Nertesi Asllani (Drejtues artistik), Bolene-Vlore

2. Berdo Berdaj, Dukat -Vlore

3. Vater Sulce, Mesaplik-Vlore

4. Mico Ferraj, Brataj-Vlore

5. Vullnet Silaj, Drizdar- Mallakaster

6. Avdi Xholi, Progonat-Tepelene

7. Adelina Asllani, Kallarat-Vlore

8. Kalo Zeneli, Velce-Vlore

9. Robert Memaj, Lezhan -Vlore

10. Sadush Kamaj, Brataj-Vlore

11. Bejushe Bajrami, Velce-Vlore

12. Mirvete Begaj, Bolene-Vlore



“Pulla nga Festivali i Beratit”



“Të njohim Fyelltarët e Gramshit ndër vite”

Akademik Vasil S. TOLE

Fyelltarët sipas fshatrave:

Kabash: Shefit Toska¹, Rexhep Toska, Beqo Toska, Qani Koka, Fadil Toska, Rrapush Toska, Hajdin Toska, Lime Toska, Vesel Toska, Kamber Toska, Hasan Nasufi, Hamit Nasufi, Murat Brami, Qamil Toska, vessel Paja, Fadil Toska, Shaban Elezi, Ali Elezi, Sabri Elezi, Zeqo Elezi.

Poroçan: Estref Buzani, Tele Cani, Halit Brami.

Fshati i Gjerë: Kapo Elezi, Aqif Carçiu, Hajdin Carçiu, Nebi Carçiu, Lime Carçiu.

Tërvol: Asllan Sinani. Hasan Sharku, Shaban Lepuri, Shaqir Sinani, Neim Sharku, Bajram Popa.

Stor: Hysni Qeti, Qemal Xhaferri, Daut Lumshi, Bajram Lumshi.

Broshtan: Medi Kumria.

Vinë: Likë Koçi, Murat Kotorri, Nexhip Bajrami, Gëzim Bajrami.

Drizë: Xhelal Elezi.

Cingar i Poshtëm: Abedin Zogu.

Gjergjovinë: Ismail Vlashi.

Kishtë: Fejzo Arapi, Servet Arapi, Kamber Trimi.

Grazhdan: Riza Mërxheku, Koçi Mërxheku.

Kukur: Refat Shuli, Isa Bega.

Gribë: Shaze Dauti, Mone Rika, Haxhi Kokla, Shyqyri Fetahu.

Rmath: Caush Mema, Shaban Tarko.

1 I njohur në popull si “Nëna e fyellit”.

Sojnik: Skënder Mullaosmani.

Mukaj: Baze Meta, Shaqir Haxhiu, Razim Guzi, Qerime Muka.

Kuratë: Zere Ibro, Rexhep Ibro, Yzeir Taçe, Afëz Taçe.

Lenie: Shahin Hasa, Zëre Toppali, Qani Hasa, Tefe Osmani.

Bratilë: Abedin Sogani, Hasan Sogani.

Kodovjat: Ymer Hysa, Bajram Shahini.

Mashan: Share Kishta, Gëzim Murati.

Gramshfshati: Riza Brahimi.

Koçaj: Hajdin Cekrezi, Bashkim Llapushi.

Bletëz: Mete Skora.

Skënderbegasi: Skënder Taçe, Myslim Zeneli.

Vidhani: Dylber Lleshi, Ylli Braçi.

Kërpica: Rexhep Gaxholli, Mete Gaxholli, Xhaferr Boçi, Berdhyl Xhepexhiu.

Kushova: Rustem Zani, Tomorr Zani.

Jança: Feta Tabaku, Jaçe Tanaku, Dylber Braçe.

Tunja: Muharrem Llaha, Faik Miraka, Xhepe Miraka, Islam Senia.

Duzha: Shefqet Latifi.

Katërlisi: Haxhi Dollani.

Prrenjas: Refat Bërdëllima, Dervish Bërdëllima.

Grekani: Dervish Cani, Demir Hysa.

Saraseli: Myrto Tërvoli, Shaban Saraseli.

Ostenthi: Tahir Ballolli.

Dufshani: Hajdar Baku, Qerim Baku, Gani Hima.

Sulti: Share Hoxha.

Kutërqara: Rexhep Duzha, Mustafa Duzha, Abaz Duzha dhe Jaup Duzha.

Darzeza: Vesel Coka, Shyqo Tafa dhe Dike Liçi.

-Qerime Osmani, fyelltarja e parë e rrethit të Gramshit. Ka marrë pjesë në FFK e Gjirokastrës 1973, së bashku me 14 fyelltarë të tjerë të Gramshit: Shaban Elezi, Ali Elezi, Qani Koka, Hajdin Toska, Kamber Toska, Mërkur Qose, Shaqir Sinani, Neim Sharku, Brahim Sinani, Estref Ymeri etj.



“Kënga e iso-polifonisë nëpër vite ”

Timo Mërkuri



Kënga iso-polifonike është një organizëm i gjallë që ecën, ndryshon e ritet nëpër vite ashtu si fëmija. Por ndërsa fëmija ritet nga të ushqyerit dhe përkujdesja e nënës, kënga ka nevojë për më shumë se kaqë. Duke qënë e madhe vetë, duhen viganë që ta marin përdore, ta ushqejnë e ta ritin duke e bërë të aftë t'i rezistojë kohës dhe zhvillimeve të saj.

Treva e Bregdetit dhe e Labërisë duke qënë djepi ku u përkund dhe u rit kënga iso-polifonike gjer në atë stad sa filloi të quhej thjeshtë “këngë labe”, kishte pothuaj të njëjtin ritëm të kënduarit, gati gati edhe të njëjtën melodi aqë sa të dukej se këndohej njësoj në të gjithë fshatrat, ndonëse me tekste të ndryshme.

Sado bukur të këndohej, krijohej një monotonie melodike e cila dalngadalë filloi tu vriste veshin njerëzve, qoftë dëgjuesve qoftë edhe vetë këngëtarëve.

Pikërisht në këtë kohë doli në skenë Neço Muko Himarjoti i cili falë dhuntisë së tij natyrore dhe dashurisë së tij për këngën, bëri hapin e madh të kënga labe, duke shpëputur prej saj këngën himarjote.

Të këndosh këngë labe nuk është e lehtë, por të këndosh këngë himarjote duhet të keshë dy palë mushkëri. Aqë e vështirë është isua në këtë këngë.

Teknika e përdorur nga Neço Muko tani është e njohur; dhënia e një funksioni të ri të hedhësit të kësaj kënge dhe forcimit të isos. Falë kësaj teknike si dhe mjeshtërisë të këngëtarëve Neço Muko, Andrea Bala, Koço Çakalli, Pano Kokaveshi etj kënga himarjote dallohej në të gjithë trevën e Himarës dhe

të Labërisë.

Ajo me të drejtë mund të quhej “Margaritari i Kurorës Iso-Polifonike”.

Në Pilur, të kënduarit qoftë labçe qoftë himarjotshe, sado mjeshtëri të kishin këngëtarët, përsëri nuk të jipte atë kënaqsi që pretendohet. Dhe pilurjotët janë vërtet këngëtarë të zotë. Mund të përmendim këtu se edhe pjestarët e grupit të Neço Mukos si A. Bala, K. Çakalli qënë nga Piluri dhe P. Kokaveshi ishte nip pilurjot. Duke qënë si të tillë ata natyrshëm e prunë “avazin” himarjot në Pilur duke spostuar në këtë mënyrë të kënduarit tradicional lab. Por po natyrshëm edhe ky “avaz” ishte dicka e importuar, pa bazë e qëndrueshmëri vendase. Duhet të sqarohet se vërtet Piluri dhe Himara janë shumë praën njëri me tjetrin, por dallimet në fizionomi, në filozofi të jetës, në mënyrën e të jetuarit dhe të konceptuarit të jetës është e ndryshme. Ska rëndësi këtu se kush është më “progresiv” apo “modern”, kush ka patur mirëqënie dhe kulturë më shumë pasi Himara është dalluar nëpër shekuj për të përballë varfërisë gati proverbiale të pilurjotëve.

Por koha ecën dhe gjithnjë pretendon.

Dhe ja, pikërisht në këtë kohë doli në skenë Lefter Çipa dhe grupi i tij pilurjot i cili që me debutimin e parë mori famë në gjithë vendin. Të kënduarit e grupit të Pilurit ndryshonte kryekëput nga gjithë grupet e mëparëshme dhe të kohës aqë sa që në melodinë e fyellit dallohej që ishte grupi i Pilurit. Ndonëse në këtë kohë dolën shumë grupe nga fshatra të ndryshëm të Bregut e Labërisë, disa shumë të suksesshëm, përsëri nëpër biseda ngrihej lart ky grup dhe Lefter Çipa si krijues i tij.

Është thënë që kënga pilurjote u shpëput nga kënga himarjote ashtu si kjo e fundit dikur u shpëput nga kënga labe. Kjo është e vërtetë, por ne do shikojmë pikërisht ndryshimin midis këngës pilurjote dhe asaj himarjote në funksion të idesë të shprehur që në fillim të shkrimit. Mundësia për të analizuar ngjashmëritë dhe dallimet e gjithë grupeve që dolën në këtë kohë është shumë e pakët për ne, prandaj le të shohin vetëm këto dy këngë, këngën himarjote dhe atë pilurjote;

1-Përbërja e grupit

a-Te kënga himarjote grupi përbëhet nga marësi, pritësi, hedhësi dhe dy gjer në katër veta mbajtës së isos .Kjo është përbërja tradicionale e këngës labe në të gjithë trevat. Në raste të ralla mund të shtohet një ose dy mbajtës së isos, por ata nuk ndryshojnë ndonjë gjë. Roli i secilit është i përcaktuar si me thënë, me kufij si rëndom te kënga labe. Është mjeshtëria e hedhësit dhe forca e mbajtësve të isos që të bëjnë të ndalosh hapin dhe ta dëgjosh me kënaqsi këtë këngë. Nuk e dime në se mund të largohet njeri nga vëndi ku këndohet kënga ‘‘Vajz’ e Valëve’’ apo ‘‘Moj nepërka pika pika.’’ Apo çfardo kënge tjetër e këtij grupi.

b-Te kënga pilurjote grupi përbëhet asnjëherë më pak se dhjetë veta duke marë një masivizim të paparë më përpara në këngën iso-polifonike.Të duket sikur në skenë është ngritur gjithë fshati dhe këndon.Të duket sikur nuk ke përpara një grup fshati por një asambël shteti.

Të gjithë këndojnë. Secili ka detyrën e tij funksionale,marësi,pritësi,hedhësi e grupi i mbajtësve të isos. Por në se te grupi i këngës himarjote i dallon lehtësisht të tërë,bile edhe mund të bësh vlerësime për secilin,te grupi i këngës pilurjote,ky kufi është i padallueshëm. Këtu duhet të përjashtojmë rolin e marësit qoftë dhe për faktin se nis këngën,por edhe se dallohet gjatë gjithë këngës duke mos u ‘‘mbytur’’ asnjëherë nga isua. Bile duhet të themi se në se bukuria e këngës himarjote qëndron në masën më të madhe të isua,te ajo iso e zgjatur dhe e forte,te kënga pilurjote bukuria qëndron më shumë te marësi zëri i të cilit lartësohet akoma më tepër,sa më shumë që forcohet isua. Te kënga pilurjote tekstin e ‘‘lexon’’ pavarësisht se isua vjen dallgë dallgë. Teksti, pra zëri i marësit qëndron gjithnjë përmbi këto dallgë iso-je.

Në qoftë se të kënga himarjote marësi pasi mbaron misionin e tij si marës,ndihmon në mbajtjen e isos,te kënga pilurjote ndodh e kundërta;mbajtësit e iso-s , në fakt një pjesë e këtij asamblu iso-mbajtës ,ndihmojnë marësin për tu evidentuar sa më tepër .

Për hir të së vërtetës duhet të pranojmë së ky grup kaq i madh,një asambël më vete,nuk qe parë ndonjëherë në këngën iso-polifonike të bregut dhe labërisë.Ky masivizim ndoshta ishte një diktat i kohës kur u ngrit dhe këndoi ky grup.Por ndërsa përgjithësisht masivizimi ul cilësinë,merita e këtij grupi dhe e krijuesve të tij qe se ky masivizim i forcoi vlerat e tij duke na dhënë një tip të ri kënge dhe bile shumë të bukur.

2-Isua te këngët

Isua është pikërisht elementi që na intereson më shumë në këto këngë të këtyre dy grupeve.Le të shohim iso-n himarjote psh te kënga ‘‘Vajz’ e valëve’’;

Marësi;*Vajz e valëve*.....

Pritësi; *O ho o o*

Marësi; *Zemëra s’ja mbaa a a n*

Hedhësi; *O o o*

Grupi i isos *A a a a a a a a a a n*

Marësi; *Mbi një gur anës së detit qan e mjera qan e gjora qan e shkreta*

qaaan

Grupi i isos *A a n*

Pra siç po e shohim isua te kënga himarjote vjen e zgjatur dhe e njëtrajtëshme dhe të duket se nuk do mbaroje kurrë. Te disa këngë të tjera është më e shkurtër si psh te kënga;’’Moj nepërka pika pika’’,por prapë është shumë e gjatë për tu mbajtur ‘‘me një frymë’’

Por këtu vlen të themi diçka për ison himarjote. E para isua është tepër magjike, për t’u dëgjuar plot me ëndje. Nuk gabojmë po të themi se pikërisht te isua qëndron gjithë bukuria e këngës, gjithë lezeti i saj .Është normale të shikosh një grup njerëzish që rinë e dëgjojnë me ëndje ison e grupit himarjot, gati gati pa marë frymë,thua se edhe frymarja e tyre mund t’i prishë punë asaj, isos.

E dyta është se isua konsiderohet gati gati e shënjtë. Përgjithësisht gjithë kënga iso-polifonike ishte e ‘‘papakëshme’’, në kuptimin që nuk guxonte kush të fliste e ta ndërpriste atë,por nëqoftë se kur ja mirte marësi, dikush pëshpëriste apo bënte gjeste me dorë,si psh sill rakinë apo mezenë, kur vinte radha e mbajtjes së isos,as era s’guxonte të frynte e jo më të bëzante dikush. Mund të ngelej edhe ai që shërbente me tabaka në dorë e të mos guxonte të lëvizte. Me sa duket pikërisht isua e trasmenton emocionin e këngës himarjote. Thua se isua ishte fjala

që nisej për te zoti lart ne qiell dhe s'guxonte kush t'ja ndërpriste rrugën .

Te kënga pilurjote gjithçka ndryshon. Le ta shohim këtë te kënga psh "Bejk e bardhë"

Marësi; *O duke tundur....*
 Pritësi; *O ho o*
 Marësi; *zbret nga mali, me shamin ulur te balli*
 Grupi i isos, hedhësi etj ; *O ho oho oho hooo ohoho ohoho ohoho*

Pastaj këndohet rëfreni ; *Tundu moj bejk e bardhë tundu*
Natënë me hënë duku
Bejk e bardh e bor e malit
Ti je moj ilaç i çobanit.

Dhe rëfreni këndohet me të njëjtën mënyrë si më sipër, pra nga të gjithë. Pra te kënga pilurjote isua nuk është e njëtrajtëshme si një zanore e stërgjatur, por vjen valë valë, duke shfrytëzuar forcën e bashkëtingëlloreve në mes të zanoreve, herë duke u ngritur dhe herë duke u ulur, por gjithmonë duke mbajtur sipër zërin e marësit në mënyrë tepër të dukëshme. Isua te kënga pilurjote vjen gjithmonë e fuqishme, si me thënë lind e fuqishme dhe jo duke u forcuar me kalimin e kohës. Ajo që në fillim të trondit. Zëje se dikush të godit me një grusht të fortë dhe duhet detyrimisht të ngrihesh në këmbë për të përballuar goditjen tjetër e cila nuk vonon te vije. Përgjithësisht këngët pilurjote nuk shijohen duke i dëgjuar ulur. Ato sjanë këngë që këndohen reth e reth tavolinës apo sofrës mbushur me meze.

Ato këndohen e shijohen vetëm në këmbë dhe ca më tepër kur tenton ti këndosh edhe vetë. Ska gjë se s'di të këndosh mirë. Sjemi në konkurs këtu. Konkurojnë të tjerët. Ti vetëm shijoi ato si të të vijë më mbarë.

3- *Fyelli.*

Për hir të së vërtetës duhet të theksojmë se i pari që futi fyellin në këngën iso-polifonike ishte Neço Muko Himarjoti te disa nga këngët e tij të inçizuara te shoqëria PATHE në Paris. Dhe kjo ishte tepër e suksesëshme. Por pavarësisht nga sukcesi te këngët ku u përdor, ky instrument nuk u bë dot pjesë përbërëse, pjesë organike e këngës himarjote. A për shkak të instrumentistit, a për shkak se ishte diçka e re dhe e padëgjuar më parë dhe nuk u pranua po me atë dëshirë që u pranua novacioni i tij te zërat e këngës. Por sido që të jetë, ai është nismëtari i këtij novacioni në këngën iso-polifonike. Të kuptohemi, fyelli ka qënë përherë shoqërues i jetës baritore në Labëri e Bregdet, shok i ngushtë në vetminë e barinjve. Nëpërmjet tingujve të tij, bariu i vetmuar sillte një shoqëri gazmore apo të trishtueshme në vetminë e tij. Nëpërmjet tingujve të tij çonte mesazhe të shpirtit të tij a në qiell a te njerzit që ndoshta e dëgjonin. Nuk është përallë dimri historia e Fyellit të Tanës.

Pra fyelli ishte shoqëruesi i bariut në vetminë e tij. Por që ai të bëhej shoqërues i një grupi njerëzish që këndonin, të bëhej shoqërues i këngës së tyre, këtë për herë të parë e praktikoi me sukses, ndonëse të pjesshëm Neço Muko Himarjoti. Aty e mori Lefter Çipa fyellin dhe e futi te grupi i Pilurit, jo në një e dy këngë por si pjestar organik i grupit polifonik. Mjafton të dëgjosh fyellin e grupit të Pilurit dhe të kuptosh se po vjen Bejka e bardhë, apo Vito Pëllumbesha apo të këndosh bashkë me tingullin e fyellit; *O në të marça manushaqe*

S' dua doktor e ilaçe
O mos u ngut o zogu i shkathët
Bregu është vënd i ashpër

Fyelli është i vetmi instrument në "asamblin" iso-polifonik të grupit të Pilurit, por pavarësisht se është i vetmi, ai jo vetëm që fillon para marësit këngën, sa që mund të themi se "bën prezantimin e grupit dhe të këngës", por e shoqëron këngën nga fillimi gjer në fund.

Fyelli është këngëtari më i madh i këtij grupi famoz.

4- *Teksti i këngës.*

